

Integrimi Evropian

...duke u bërë pjesë e familjes së BE-së dhe NATO-s, Shqipëria do të zërë vendin që i takon

Integrimi Evropian është prioriteti më i lartë në agjendën politike të Qeverisë së shqiptare. Ky proces bëhet edhe më i rëndësishëm në këtë periudhë kur Shqipëria ka parashtruar aplikimin e saj për t'u bërë një vend kandidat i BE-së. Marrëveshja e Stabilizim Asociimit (MSA) hyri në fuqi në Prill 2009, ndërsa në 4 prill 2009 Shqipëria u bë anëtare e NATO-s. Një arritje domethënëse në historinë e bashkëpunimit Shqipëri – BE ishte vendimi i Këshillit të Ministrave të BE-së në favor të liberalizimit të vizave për qytetarët shqiptarë për të udhëtuar në zonën Shengen, duke filluar që nga 15 dhjetori 2010.

Ministria e Integrimit Evropian ka qenë në pozita drejtuese gjatë procesit të koordinimit të agjendës për Integrimin Evropian që prej negociatave, nënshkrimit (12 Qershor 2006) të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit dhe Marrëveshjes së Përkohshme me BE-në. Nën drejtimin e Ministrisë së Integrimit Evropian, institucionet shqiptare kanë prodhuar dhe rishikuar çdo vit (duke filluar nga viti 2004) Planin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së. Një sistem i ri elektronik monitorimi dhe raportimi 3 mujor mbi zbatimin e këtij Plani është vënë gjithashtu në funksionim.

Ngritja e një mekanizmi të përbashkët dhe efikas BE-Shqipëri për monitorimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të MSA-së është sfida e parë që paraqitet pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes. Janë ngritur gjithashtu Këshilli i MSA-së dhe Komiteti i MSA-së.

Programi IPA ka akorduar një ndihmë të konsiderueshme financiare në mbështetje të procesit të Integrimit Evropian në Shqipëri. Futja në Sistemin e Zbatimit të Decentralizimit do t'u japë institucioneve Shqiptare mundësinë të rrisin kapacitetet dhe pronësinë e tyre në menaxhimin e asistencës së BE-së si dhe do të ndihmojë në një integrim më të mirë të financimit IPA në sistemet e planifikimit dhe të menaxhimit financiar të Qeverisë. Lidhja koherente midis strategjive dhe politikave të Qeverisë shqiptare dhe fushave potenciale për ndërhyrje përmes Komponentit III (Zhvillimi Rajonal) dhe IV (Zhvillimi i Burimeve Njerëzore) të IPAs, po artikulohen në një dokument Kuadër Strategjik Koherent.

Proceset kyçe dhe rezultatet

MSA-ja u nënshkrua në Qershor të vitit 2006 dhe hyri në fuqi në 1 Prill 2009 nëpërmjet ratifikimit nga të gjitha shtetet anëtare.

Shqipëria mori ftesën për anëtarësim në NATO në Prill të vitit 2008 dhe u bë anëtare në 4 prill 2009 në Samitin e Bukureshtit.

Shqipëria aplikoi për statusin e vendit kandidat në 28 Prill 2009. BE paraqiti opinionin në 9 nëntor 2010. Puna për të reflektuar rekomandimet e opinionit është në progres.

Liberalizimi i vizave me vendet e BE u bë efektive në 15 dhjetor 2010.

Marrëveshja financiare IPA 2010 u firmos në Mars 2011, ndërkohë që procesi I planifikimit të IPA 2011 ka përfunduar.

Procesi i përkthimit të “*acquis*” në shqip ka filluar në 2007 dhe po procedon normalisht.

Integrimi i plotë i agjendës për Integrimin Evropian me agjendën e përgjithshme të zhvillimit dhe përparësitë e Qeverisë mbetet sfida kryesore. Të gjitha përpjekjet e përqendruara në kuadër të zbatimit të SPI-së po prodhojnë rezultatet e para pozitive të pasqyruara në një reflektim më të mirë të iniciativave për Integrim Evropian në përparësitë dhe shpenzimet e PBA-së. Riorganizimi i Grupit Koordinues të SPI-së i krijuar nën drejtimin e Ministrit të Inovacionit dhe Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, ka forcuar koordinimin dhe dialogun politik mes DEBASKON-it, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Integrimit Evropian.